

# atrc

Qendra e Trajnimeve & Burimeve për Avokim



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERICKOG NARODA

Perkrah

komunitetin e OJQ-ve



Vëllimi IV • Numri 8 • Shtator 2006

# AVOKUESI

## ATRC ofron trajnime pa pagesë për OJQ-të kosovare

### PËRMBAJTJA

#### Faqe 2

"Shoqëria civile mund të ndikoj në vendimet e qeverisë"

"Në përkrahje të një zgjidhjeje të drejtë dhe të qëndrueshme për Kosovën"

#### Faqe 3

Kosova mëson nga përvojat rajonale për procesin e integritimit në BE

Shoqëria civile kërkon nga Komuna e Prishtinës organizim të debateve publike

BE-ja, OJQ-të debatojnë rregulloret financiare

#### Page 4

Shoqëria civile diskuton partneritetet e efektshme për mbrojtjen e të drejtave dhe zhvillim të qëndrueshëm në Konferencën e 59 Vjetore të OKB-së për OJQ-të

Udhëzues të ri të OKB-së përfshijnë shoqërinë civile në hartën ekonomike të botës

### Mundësi të reja financimi, lajme, aktivitete, trajnime, etj

mund të lexoni në web faqen e ATRC-së: [www.advocacy-center.org](http://www.advocacy-center.org)

Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC) ka realizuar trajnime për menaxhim të ciklit të projektit; shkrim të projekt propozimit; dhe hyrje në avokim dhe ndërtim të koalicionit më 6-8; 20-21 shtator; dhe 4-5 tetor, në të cilat kanë marrë pjesë përfaqësues të OJQ-ve lokale.

Trajnimi për menaxhim të ciklit të projektit ka përfshirë komponentët kryesore të menaxhimit të projektit siç janë zhvillimi i idesë, nevoja për analizë, shkrimi i propozimit, implementimi i projektit, monitorimi, vlerësimi, buxheti dhe qëndrueshmëria. Pjesëmarrësit janë njoftuar me metodologjitë dhe mënyrat e përdorura në menaxhimin e suksesshëm të projektit.

Trajnimi për shkrim të projekt propozimit ka përfshirë shqyrtimin e përgjithshëm të shkrimit të një projekt propozimi, përfshirë të gjitha element e nevojshme për projekt propozim. Metodologjia e trajnimit është bazuar në qasjen logjike të punës, duke iu mundë-



Sesion trajnimi në ATRC më 21 Shtator

suar pjesëmarrësve zhvillimin e projekteve që nga idetë fillestare për një problem ose çështje.

Ndërsa trajnimi për avokim dhe ndërtim të koalicionit i ka informuar pjesëmarrësit për metodat e rëndësishme, të nevojshme për punë avokuese.

Këto sesione trajnime janë pjesë e trajnimeve të sivjetme.

Gjatë 2006-ës, ATRC-ja ofron trajnime të tjera (siç janë të radhitura më poshtë). Shërbimet janë pa pagesë për OJQ-të kosovare të regjistruara në ATRC. Për t'u regjistruar,

OJQ-të duhet ta plotësojnë Formën e Regjistrimit të OJQ-ve Klientë, e cila ndodhet në [www.advocacy-center.org](http://www.advocacy-center.org).

Trajnimet e ardhshme të ATRC-së gjatë 2006-ës janë:

24-26 Tetor: Menaxhimi i OJQ-së

29-30 Nëntor: Shkrim i Projekt Propozimit

Trajnimet zhvillohen në ATRC: Rr. Agim Ramadani, Nr.15, Prishtinë.

Për më shumë informata, kontaktoni 038 244 810 ose shkruani në e-mail-in [training@advocacy-center.org](mailto:training@advocacy-center.org).

Publikimi i këtij buletini mundësohet nga përkrahja zemërgjerë e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e ATRC-së dhe nuk reflekton detyrimisht qëndrimet e USAID-it ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

**Lobi i grave rajonale i ka dorëzuar letër Martti Ahtisaarit**

**"Në përkrahje të një zgjidhjeje të drejtë dhe të qëndrueshme për Kosovën"**



Lobi i Grave Rajonale për Paqe, Siguri dhe Drejtësi në Evropën Juglindore gjatë një takimi në Vjenë më 11 shtator i ka dorëzuar letër Martti Ahtisaarit, të Dërguarit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së i angazhuar në negociatat për statusin e ardhshëm të Kosovës. Letra përkrah pavarësinë e Kosovës.

Letra është e nënshkruar nga anëtarët e lobit, i cili është formuar pas konsultimeve në mesin e grave lidere politikane dhe aktivisteve të drejtave të njeriut nga vendet e Evropës Juglindore.

Në letër shkruan:

*Lobi i Grave Rajonale për Paqe, Siguri dhe Drejtësi, gjatë një takimi në Vjenë më 9-10 shtator 2006, adresoi bisedimet e Vjenës për statusin e Kosovës dhe vendosi të ndaj me ju si vijon:*

*Duke pasur parasysh se zgjidhja e statusit të Kosovës, sa më shpejt që të jetë e mundur, është domosdoshmëri për stabilitet të qëndrueshëm rajonal;*

*Duke paralajmëruar se çfarëdo zgjidhje duhet të mos shkaktoj përçarje të reja që do të mund të nxisnin tensione dhe parandalonin paqen e qëndrueshme...*

Për letrën e plotë, vizitoni: [www.womensnetwork.org](http://www.womensnetwork.org).

## Roli i shoqërisë civile

### "Shoqëria civile mund të ndikoj në vendimet e qeverisë"

OJQ-të dhe qytetarët mund të ndikojnë në vendimet e qeverive gjatë administrimit të vendeve të tyre, komentojnë ekspertët të BE-së për çështje të shoqërisë civile. Sipas tyre, shoqëritë që janë në dijeni të ndikimit që mund të kenë në vendim-marrjes mund t'i orientojnë vendet e tyre larg keq menaxhimit dhe mund të parandalojnë përhapjen e korrupsionit. "Cilado qeveri që nuk e njeh këtë (fuqinë e popullit) rrezikon të dështoj herët a vonë".

Igballe Rogova dhe Alban Krasniqi kryesojnë dy rrjetet më të mëdha të OJQ-ve në Kosovë. Rogova, drejtoreshë e Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK), ka pohuar se ky rrjet punon për zhvillimin e një shoqërie civile të fuqishme, transparente dhe efektive për të avokuar në nivel lokal dhe kombëtar. Ajo një sistem të ri zgjedhor me lista të hapura e konsideron mundësi të re për shoqërinë që të ndikoj në vendimet e qeverisë në Kosovë. "Përfaqësuesit që ne (qytetarët) i zgjedhim do të jenë përgjegjës për punën që bëjnë".

Rogova beson se shoqëria civile mund të ndikoj në vendimet e qeverisë, mirëpo sipas saj qeveria aktuale nuk e dëgjon shoqërinë civile. "Shoqëria civile në Kosovë nuk ka ndikim për të ndryshuar vendimet e qeverisë", ka thënë ajo.

Alban Krasniqi, kryesues i Rrjetit të Rinjve të Kosovës (RrRK), ndan të njëjtin mendim me Rogovën. Ai



*Rrjeti i Grave të Kosovës ka 85 organizata anëtare të të gjitha etniteteve në mbarë Kosovën*

shton se përderisa ekziston mundësia që OJQ-të të ndikojnë në vendim-marrje, ato nuk janë treguar të suksesshme në shfrytëzimin e kësaj mundësie. Sipas Krasniqit, ndikimi në të ardhmen varet nga ajo se sa vlerat dhe praktikat demokratike do të inkorporohen në shoqëri, si dhe nga përkrahja e komunitetit ndaj OJQ-ve.

"Vetë shoqëria civile është e brishtë", ka thënë ai. "Mungon guximi qytetar për të ndërmarrë veprimet e



*Rrjeti Rinor i Kosovës është rrjet multietnik i cili përfaqëson 124 qendra dhe organizata rinore në mbarë Kosovën*

nevojshme për të ndikuar tek vendimet e qeverisë". RrRK tenton të ngritë aktivizimin qytetar në mesin e të rinjve në mënyrë që ata të luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimet e ardhshme në Kosovë, ka theksuar ai.

Me gjithë kufizimet, një sërë OJQ-sh kanë pasur ndikim tek qeveria në nivel

lokal dhe kombëtar, e sidomos duke avokuar për ligje të reja.

RrGK në bashkëpunim me gratë politike dhe organizatat ndërkombëtare kanë hartuar dhe pastaj avokuar për miratimin e Planit Nacional të Veprimit për Arritje të Bazarisë Gjimore, i cili është aprovuar nga

qeveria në prill 2004.

Shembull tjetër është "Epoka e Re", OJQ kjo nga Deçani, e cila ka avokuar për miratimin e Rregullores për Pjesëmarrje dhe Konsultime Publike në Vendim-marrje në nivel lokal. Rregullorja është miratuar nga Asambleja Komunale në maj 2003.

Rrjeti i Grave të Kosovës mbron dhe promovon të drejtat e grave dhe femrave në Kosovë. Ky rrjet avokon në emër të grave në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar; dhe ka 85 organizata anëtare të të gjitha etniteteve në mbarë Kosovën, duke qenë kështu një ndër rrjetet më të mëdha funksionale në rajon.

*Për më shumë informata, vizitoni: [www.womensnetwork.org](http://www.womensnetwork.org)*

Rrjeti Rinor i Kosovës është rrjet i pavarur, shumë etnik, i cili përfaqëson 124 qendra dhe organizata rinore në mbarë Kosovën. Rrjeti synon të ngrit kapacitetet e të rinjve për t'i adresuar më mirë nevojat e tyre dhe të luajnë rol të rëndësishëm për një shoqëri të lirë, të hapur, demokratike në Kosovë.

*Për më shumë informata, vizitoni: [www.kosyouth.net](http://www.kosyouth.net)*

## BE-ja, OJQ-të debatojnë rregulloret financiare



Rregullorja Financiare e BE-së përmban të gjitha normat që kanë të bëjnë me grantet e BE-së për OJQ-të. Shumë OJQ, në nivel evropian dhe kombëtar, një kohë të gjatë kanë konsideruar se procesi i dhënies së granteve të BE-së duhet të jetë më efikas dhe më pak burokratik në realizimin e qëllimeve të BE-së.

Për të bërë sugjerime pozitive, Platforma Sociale, në bashkëpunim me Qendrën e politikave Evropiane, dhe Lobi e Grave Evropiane, ka autorizuar realizimin e një studimi për të ekzaminuar rregulloren financiare dhe për të bërë propozime të hollësishme për të përmirësuar marrëdhënien ndërmjet OJQ-ve dhe Komisionit Evropian.

Raporti 90 faqesh konstaton se "Partneriteti kreativ ndërmjet OJQ-ve dhe Komisionit Evropian po rrezikohet nga aplikimi tepër i ashpër i rregulloreve lidhur me financimin e aktiviteteve të OJQ-ve. Komisioni vazhdimisht ka ndjekur procedurat lidhur me shkaktim të dëmtimit të efikasitetit të programeve të tyre, duke shpenzuar shumë para për burokraci të panevojshme dhe joefikase. Komisioni ka mundur t'u shmangët shumë problemeve të shaktuara nga Rregulloret e tyre Financiare po qe se do të ishin konsultuar OJQ-të. Tash kur rregulloret po shqyrtohen, rrezikohet përsëritja e sërishme e gabimeve duke mos konsultuar OJQ-të".

*Kopjen e plotë të raportit mund ta lexoni në: <http://www.socialplatform.org/module/FileLib/StrikingaBalance.pdf>*

## Konferenca rajonale për ndihmën financiare të BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor

### Kosova mëson nga përvojat rajonale për procesin e integritimit në BE

Zyrtarë komunal dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe lokale kanë diskutuar për avancimin e qeverisjes lokale në Kosovë dhe integrimin në BE gjatë një konference dy-ditëshe në Prishtinë më 7-8 shtator, të titulluar "Asistenca financiare e BE-së për Ballkanin Perëndimor - mundësitë për Qeveritë Lokale".

Përfaqësues të qeverive të Sllovenisë, Bosnjë Hercegovinës, Kroacisë, Shqipërisë dhe Maqedonisë, ishin gjithashtu pjesëmarrës, dhe këmbyen përvojat e vendeve të tyre gjatë proceseve integruese në BE.

Linda Bunjaku nga Fondi për Zhvillim të Komunitetit veçoi rëndësinë e diskutimit për integrimin evropian. "BE-ja ka hapur dyert e saj për Ballkanin Perëndimor, dhe ky është hap i madh drejt integritimit të tërë rajonit në këtë union me standarde të larta", ka thënë ajo.



*Pjesëmarrësit diskutojnë avancimin e qeverisjes lokale dhe integrimin në BE më 7-8 Shtator, Prishtinë*

Përmes dialogut të vazhdueshëm dhe përkrahjes financiare nga BE-ja, Kosova gradualisht po avancohet në agjendën evropian, ka komentuar Aziz Lila, zëvendës ministër i pushtetit lokal.

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) ka

organizuar këtë konferencë në partneritet me Ministrinë e Pushtetit Lokal dhe me përkrahjen e Fondit për Zhvillim të Komunitetit (CDF), Zyren Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë dhe Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP).

*Për më shumë informata, kontaktoni [office@kcsfoundation.org](mailto:office@kcsfoundation.org)*

## Tryezë e rumbullakët e inicuar nga OJQ-të

### Shoqëria civile kërkon nga Komuna e Prishtinës organizim të debateve publike

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka organizuar tryezë të rumbullakët për punën e Komunës së Prishtinës, në të cilën më 30 gusht në ATRC u mbledhën përfaqësues të komunës, partive politike dhe shoqërisë civile.

Gjatë këtij takimi, organizatorët shpresuan të shqyrtohen mënyrat e përmirësimit të bashkëpunimit ndërmjet organeve ligjvënëse dhe ekzekutive në Komunën e Prishtinës.

Përfaqësuesi i opozitës Shemi Veseli, këshilltar



*Komuna, partitë politike dhe shoqëria civile shqyrtojnë punën e Komunës së Prishtinës më 30 gusht në ATRC*

komunal nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) kritikoi mungesën e llogaridhënies të ekzekutivit ndaj organit ligjvënës. "Asambleja Komuna nuk monitoron punën

e ekzekutivit", ka thënë ai.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile u ankuan po ashtu për mos organizimin e debateve publike nga Komuna e Prishtinës për çështje me interes për qytetarët.

Instituti Demokratik i Kosovës është OJQ e cila monitoron punën e organeve ligjvënëse dhe shfrytëzon këto të dhëna për të avokuar për çështje të caktuara.

*Për më shumë informata, kontaktoni [kdi.kosova@gmail.com](mailto:kdi.kosova@gmail.com)*





**Drejtoreshë Ekzekutive**  
RREZE DULI  
rreze@advocacy-center.org

**Menaxher i Financave &  
Administratës**  
GANI ASLLANI  
gani@advocacy-center.org

**Trajnere & Konsultante**  
DONIKA SALIHU  
donika@advocacy-center.org

**Trajnere & Konsultante**  
AFERDITA SURROI  
aferdita@advocacy-center.org

**Trajner & Konsultant**  
KUSHTRIM ISLAMI  
kushtrim@advocacy-center.org

**Menaxhere për Komunikim  
& Ndërlidhje**  
ARJETA DOROCI  
arjeta@advocacy-center.org

**Menaxhere e Projekteve**  
NATYRA ZHJEQI  
natyra@advocacy-center.org

**Menaxher për IT dhe  
Databasë**  
ARSIM KOSUMI  
arsim@advocacy-center.org

**Rr. Agim Ramadani Nr. 15**  
Kati i 2-të Prishtinë, Kosovë  
Telefon/Fax: +381 (0) 38 244  
810

## Shoqëria civile diskuton partneritetet e efektshme për mbrojtjen e të drejtave dhe zhvillim të qëndrueshëm në Konferencën e 59 Vjetore të OKB-së për OJQ-të

Më shumë se 2,500 përfaqësues të OJQ-ve dhe aktivistë të tjerë të shoqërisë civile nga më shumë se 90 vende u mbledhën në selinë e Kombeve të Bashkuara në New York për të diskutuar punën e papërfunduar të implementimit të Synimeve për Zhvillim të Mileniumit. Ata u takuan prej 6 deri më 8 shtator gjatë një takimi vjetor treditor, i organizuar nga Departamenti i OKB-së për Infor-

mim të Publikut në partneritetet me OJQ-të bashkëpunëtoare. Konferenca u përqendrua në Partneritetet e Efektshme për Mbrojtje të të Drejtave dhe Zhvillim të Qëndrueshëm.

Ky takim vjetor i OJQ-ve, shoqërisë civile dhe sektorit privat me përfaqësues të OKB-së, ofroi forum për rrjetëzim dhe këmbim të praktikave më të mira për çështjet e diskutuara.

Konferenca përkrahu ndër-

timin strategjikë të partneritetit duke ftuar përfaqësues të shteteve anëtare që të kyçen në dialogun me pjesëmarrësit e konferencës. Ky vit ofroi forum për përcaktimin e politikave për bashkëpunim të OJQ-ve me OKB-në.

*Faqja e Internetit dedikuar konferencës është <http://2006.undpingoconference.org>.*

*Burimi: Departamenti i OKB-së për Informim të Publikut*



## Udhëzues të ri të OKB-së përfshijnë shoqërinë civile në hartën ekonomike të botës

Rezultatet e para nga miratimi i një udhëzuesi të ri raportues të OKB-së tregojnë se në mbarë botën sektori joprofitabil është shumë më i gjerë dhe dinamikë sesa që është njohur paraprakisht, ka raportuar një profesor i Universitetit Johns Hopkins më 6 shtator në Konferencën e 59të Vjetore për OJQ të OKB-së.

I publikuar më 2003, Udhëzuesi i ri i OKB-së për

Institucionet Joprofitabile në Sistemin Kombëtar të Llogaritjes Financiare u bënë thirrje agjencive kombëtare të statistikave që të dokumentojnë qartë për herë të parë madhësinë dhe rëndësinë ekonomike të shoqërisë civile, bamirësisë, dhe shumë vende tashmë iu janë përgjigjur kësaj kërkesë, ka thënë profesori Lester Salaman. Salaman është drejtor i Qendrës për

Studime të Shoqërisë Civile në Institutin Johns Hopkins për Studime të Politikave, e cila ka përpiluar Udhëzuesin në bashkëpunim me Divizionin Statistikor të OKB-së dhe tashmë po përpiqet të sigurojë implementimin e tij.

"Bazuar në të dhënat e reja, organizatat joprofitabile po fitojnë kredibilitet të ri në mbarë botën", ka deklaruar Salamon.

### Projekti i OKB-së për Udhëzuesin Joprofitabil

Projekti i OKB-së për Udhëzuesin Joprofitabil synon përmirësimin e trajtimit të organizatave joprofitabile ose shoqërisë civile në kuadër të statistikave kombëtare. Pengesë kryesore për të kuptuar më mirë sektorin joprofitabil është mungesa e statistikave themelore për fushëveprimin, strukturën, financimin, dhe aktivitetet e këtij lloji të organizatave.

Statistikat ekonomike kombëtare nuk llogarisin punën e shumë vullnetarëve. Kjo vështrimson sigurimin e një këndvështrimi gjithëpërfshirës për fushëveprimin dhe kontributet e organizatave joprofitabile.

Për më shumë informata lidhur me Udhëzuesin e OKB-së për Institucionet Joprofitabile si dhe për rezultatet e implementimit të deritashëm, vizitoni <http://www.jhu.edu/ccss/unhandbook>.

*Burimi: Qendra për Studime të Shoqërisë Civile e Institutit për Studime të Politikave të Universitetit Johns Hopkins*